



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 1, Datë 14.10.2020

PËR

MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR SEKTORIAL TË TRANSPORTIT DETAR DHE
INFRASTRUKTURËS PORTUALE

Në mbështetje të neneve 7, 8, 9, 10, 17 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar, të VKM Nr. 881 datë 14.12.2016 “Për miratimin Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit”, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, të Vendimit Nr. 1, datë 07.10.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e dokumentit të nismës për hartimin e Planit Kombëtar Sektorial të Transportit Detar”, me propozimin e Ministrisë së Infrastrukturës së Energjisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar Sektorial të Transportit Detar dhe Infrastrukturës Portuale, (PKS TDIP), pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtme:
 - a) Dokumenti i Planit, i cili përmban:
 - a. Strategjinë sektoriale shoqëruar me analizën sektoriale dhe territoriale, vizionin dhe objektivat strategjike të zhvillimit
 - b. Plani i zhvillimit të sektorit, propozimet me përcaktime territoriale, plani i veprimeve dhe rregullorja e Planit
 - b) Materiali Hartografik.
2. Gjatë hartimit të planeve të tjera sektoriale kombëtare, planeve të detajuara për zona të rëndësishme kombëtare, planeve sektoriale në nivel qarku, planeve të përgjithshme vendore, projekteve strategjike dhe pilot të zhvillimit, si dhe të tjera të ngjashme me to, autoritetet përgjegjëse të

planifikimit dhe zhvillimit të territorit në nivel qendror, qarku dhe atë vendor, duhet të bazohen në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani Kombëtar Sektorial i Transportit Detar dhe Infrastrukturës Portuale.

3. Ngarkohen Autoritetet Portuale / Portet që për vendndodhjet e reja apo të zgjerimit të porteve të marrin masat e nevojshme në zbatim të legjislacionit sektorial dhe atij për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, për sigurimin e ekspertizës më të mirë kombëtare apo ndërkombëtare për hartimin e planeve të përdorimit dhe administrimit të tokës (masterplan), në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar Sektorial të Transportit Detar dhe Infrastrukturës Portuale.
4. Ngarkohet Autoriteti Portual Durrës që brenda muajit nëntor 2020 të marrë masat për:
 - a. hartimin e planit të ri të përdorimit dhe administrimit të tokës (masterplan);
 - b. hartimin e dokumenteve tekniko-ligjore që do të orientojnë Autoritetin Portual për zhvillimin e operacioneve portuale, shërbimeve dhe investimeve në infrastrukturën detare dhe tokësore të terminaleve përkatëse, në përputhje me zonat e përcaktuara në Planin Kombëtar Sektorial të Transportit Detar dhe Infrastrukturës Portuale;
 - c. për përgatitjen e praktikës tekniko-ligjore për miratimin e masterplanit në përputhje me përcaktimet e legjislacionit sektorial.
5. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që në bashkërendim me "Portin Detar Vlorë" sh.a, të marrë masat e nevojshme në zbatim të legjislacionit sektorial dhe atij për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, për përditësimin e planit të përdorimit dhe administrimit të tokës (masterplanit) në Portin e Peshkimit - Triport, në përputhje me nevojat për zhvendosje të Portit Detar Vlorë, sipas përcaktimeve të Planit Kombëtar Sektorial të Transportit Detar dhe Infrastrukturës Portuale.
6. Ngarkohen Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Lezhë, Durrës, Vlorë dhe Sarandë të marrin masa që, pas miratimit, PKS TDIP të integrohet me planet e përgjithshme vendore, duke ndjekur përcaktimet e vendimit nr.686, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", të ndryshuar.
7. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për kontrollin e përputhshmërisë së dokumentave të planifikimit, që hartohen nga autoritetet përgjegjëse të planifikimit të territorit, me përcaktimet e Planit Kombëtar Sektorial të Transportit Detar dhe Infrastrukturës Portuale.
8. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e varësisë përgjegjëse për infrastrukturën, energjinë, turizmin, mjedisin, bujqësinë, agjencitë përgjegjëse për zbatimin e projekteve, si dhe çdo autoritet tjetër fusha e veprimtarisë së të cilit lidhet me territoret subjekt të këtij vendimi, për zbatimin e Planit Kombëtar Sektorial të Transportit Detar dhe Infrastrukturës Portuale.
9. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

EDI RAMA



BELINDA BALLUKU

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

